



Pranuar / Dorezuar Prilijeno/Prodato Received/Delivery	UJ. 11	2020	viti god year
Organ./Njësia Organ./Jedinica Org./Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
OKPM/408		24857	119



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVA

A.nr.263/2020

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për shqyrtimin e ankesave i përbërë nga: Ardita Haxhnikaj Demi, kryetare, Arben Mehmeti dhe Eshref Shabani anëtarë, si dhe Çlirim Zeka, Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional, në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën A.Nr.263/2020, të datës 08.09.2020, e parashtruar nga [REDACTED], me adresë banimi Lagjja Arbëria Rr., Ahmet Krasniqi", Nr. 208, nga Komuna e Prishtinës, kundër organit të punësimit Autoriteti i Aviacionit Civil të Kosovës, në çështjen juridike "heshtje administrative", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1.1 nën paragrafin 1.1, dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.7 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim me datë 05.11.2020, mori këtë;

V E N D I M

Hedhet poshtë si e palejuar ankesa me numër A.nr.263/2020 e datës 08.09.2020, e parashtruar nga ankuesja [REDACTED].

A r s y e t i m

Ankuesja [REDACTED], Drejtoreshë e Departamentit për Administratë dhe Burime Njerëzore, në Autoritetin e Aviacionit Civil të Kosovës, me datën 23.07.2020 ka parashtruar kërkesë me Nr.2020/ADM/186, pranë Komisionit Disiplinor në AACK për inicim të procedurës disiplinore kundër Sadete Krasniqi, në pozitën e punës "menaxhere e prokurimit", me arsyetimin se pa asnjë njoftim dhe aprovim nga mbikëqyrësi ka munguar disa ditë radhazi respektivisht nga data 07-10.07.2020, 14-17.07.2020 dhe 20.07.2020.

Komisioni Disiplinor i AACK-së, nuk ka zhvilluar procedurë disiplinore sipas kërkesës së ankueses [REDACTED] e parashtruar kundër Sadete Krasniqi. Ankuesja e pakënaqur me këtë mosveprim të Komisionit Disiplinor, më datë 08.09.2020 parashtron ankesë me numër protokollit 1706/2020 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me pretendimet ankimor se Komisioni Disiplinor nuk ka trajtuar kërkesën e sajë

Nr.2020/ADM/186 të datës 23.07.2020 për inicim të procedurës disiplinore ndaj Sadete Krasniqi, duke kërkuar që të merren masa disiplinore nga Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës i Shërbimit Civil, sipas shkeljeve të paraqitura në kërkesë ose që të kthej çështjen në Komision Disiplinor të ACCK-së për shqyrtim dhe vendosje.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datë 16.09.2020, ka proceduar tek Autoriteti i Aviacionit Civil të Kosovës, ankesën e ankuesit për përgjigje në ankesë, ndërsa më datën 29.09.2020 Këshilli ka pranuar përgjigjen në ankesë se bashku me provat e bashkangjitura.

Administrimi i provave-Kolegji për shqyrtimin e ankesave ka administruar këto prova: Ankesën A nr.263/2020, të datës 08.09.2020, me numër protokolli 1706/2020, drejtuar Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Kërkesë për përgjigje në ankesë e datës 16.09.2020; Kërkesë Inicim i procedurës disiplinore ndaj Sadete Krasniqi; e-mail nga [redacted] për Sadete Krasniqi i datës 22.07.2020; e-mail nga [redacted] për Sadete Krasniqi i datës 21.07.2020; e-mail nga Sadete Krasniqi për [redacted] i datës 21.07.2020; e-mail nga [redacted] për Sadete Krasniqi i datë 21.07.2020; e-mail nga Sadete Krasniqi për [redacted] i datës 16.07.2020; e-mail nga [redacted] për Bujar Ejupi i datës 10.07.2020; e-mail nga [redacted] për Bujar Ejupi i datës 08.07.2020; e-mail nga Sadete Krasniqi për Shqipe Selishta i datës 16.07.2020; e-mail nga [redacted] për ankesa.kpmschk@rks-gov.net ; përgjigje në kërkesën tuaj nga Safete Selmani për Çlirim Zeka i datës 29.09.2020; Përgjigje në kërkesën e pranuar të datës 29.09.2020; e-mail nga Safete Selmani për Bujar Ejupi i datës 29.09.2020; e-mail nga Safete Selmani për Bujar Ejupi i datës 24.09.2020; e-mail nga [redacted] për Sadete Krasniqi i datës 22.07.2020; e-mail nga [redacted] për Sadete Krasniqi i datës 21.07.2020; e-mail nga Sadete Krasniqi për [redacted] i datës 21.07.2020; e-mail nga [redacted] për Sadete Krasniqi i datës 21.07.2020; e-mail nga Sadete Krasniqi për Hysa Matoshi i datës 16.07.2020; e-mail nga [redacted] për Sadete Krasniqi i datës 15.07.2020; e-mail nga [redacted] për Bujar Ejupi i datës 10.07.2020; e-mail nga [redacted] për Bujar Ejupi i datës 08.07.2020; e-mail nga Sadete Krasniqi për Shqipe Selishta i datës 16.07.2020; Akt Emërimi i datës 08.06.2018; Përshkrimi i Detyrave të Punës i datës 16.03.2017; e-mail nga Driton Avdiu për Sadete Krasniqi i datës 07.07.2020; e-mail nga Sadete Krasniqi për Safete Selmani i datës 24.09.2020; e-mail nga [redacted] për Sadete Krasniqi i datës 22.07.2020; e-mail nga [redacted] për Sadete Krasniqi i datës 21.07.2020; e-mail nga Sadete Krasniqi për [redacted] i datës 21.07.2020; e-mail nga [redacted] për Sadete Krasniqi i datës 21.07.2020; e-mail nga Sadete Krasniqi për Hysa Matoshi i datës 16.07.2020; e-mail nga [redacted] për Sadete Krasniqi i datës 15.07.2020; e-mail nga [redacted] për Bujar Ejupi i datës 10.07.2020; e-mail nga [redacted] për Bujar Ejupi i datës 08.07.2020; Qarkore Informative e datës 10.07.2020; Vendim i datës 17.06.2020; Vendim i datës 17.07.2019; Ndryshimi dhe Plotësimi i Aktit të Emërimit i datës 19.07.2019; Përshkrimi i Detyrave të Punës i datës 19.07.2020; Vendim i datës 22.10.2020; Kërkesë për shtyrje të afatit për vendosjen e ankesës i datës 22.10.2020; e-mail nga Safete Selmani për Çlirim Zeka i datës 05.11.2020; e-mail nga Çlirim Zeka për Safete Selmani i datës 04.11.2020; Fletkthesë e datës 23.10.2020; Fletkthesë e datës 23.10.2020;

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, pas shqyrtimit të të gjitha shkresave të lëndës të parashtruara nga palët, konstatoi se ankesa e ankueses ██████████, është e pa lejuar, sepse:

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, bazuar në Aktin e Emërimit të datës 19.09.2019, përshkrimin e detyrave të punës të nëpunëses civile Sadete Krasniqi, si dhe konfirmimin me shkrim të datës 05.11.2020 të dërguar nga Menaxherja e Personelit i Autoritetit të Aviacionit Civil, ka konstatuar se Sadete Krasniqi, është e emëruar në pozitën e punës Menaxhere e Prokurimit, me afat të përhershëm dhe e njëjta i raporton drejtpërdrejtë Drejtorit të Përgjithshëm të Autoritetit të Aviacionit Civil të Kosovës.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave bazuar në shkresat e lëndës gjënë se kërkesa për inicim të procedurës disiplinore ndaj Sadete Krasniqit nuk është dërguar paraprakisht për shqyrtim te Drejtori i Përgjithshëm si udhëheqës i drejtpërdrejtë i Sadete Krasniqit, siç përcaktohet me dispozitat e nenit 48 paragrafi 2 dhe 4 të Ligjit NR. 06/L-114 për Zyrtarët Publik dhe Nenin 6 paragrafi 1 të Rregullores (QRK) Nr. 11/2020, për Disiplinën dhe Ankesat e Zyrtarëve Publik. Bazuar në këtë, Kolegji vlerëson së ankuesja ██████████ meqenëse nuk është mbikëqyrëse e drejtpërdrejtë e Sadete Krasniqit, e njëjta nuk ka mundur të inicioj procedurë disiplinore drejtpërdrejtë në Komision Disiplinor.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, bazuar në shkresat e lëndës konstatoj se në çështjen juridike kontestuese mungon legjitimiteti juridik i ankueses/palës, për faktin se mos zhvillimi i procedurës disiplinore sipas kërkesës së ankueses të datës 23.07.2020 kundër Sadete Krasniqit nuk ka prodhuar ndonjë pasojë juridike lidhur me të drejtat dhe interesat juridike të ankueses, respektivisht nuk është cenuar ndonjë e drejtë apo interes juridik i ankueses që do të përbënte shkak të arsyeshëm ligjore që ankuesja të parashtronte ankesë kundër komisionit gjegjës për heshtje dhe mosveprim, siç parashihet me dispozitat e Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, përkatësisht nenin 124 i cili përcakton se: *pala ka të drejtë të ushtrojë mjetet juridike administrative ndaj çdo veprimi apo mosveprimi administrativ, nëse pretendon se të drejtat apo interesat e saj juridike cenohen nga ky veprim apo mosveprim, ndërsa 129 i po të njëjtit Ligj përcakton: ankesa është e pranueshme nëse i plotëson këto kushte: 1.2. ankuesi ka legjitimitet në përputhje me nenin 124 të këtij Ligji.*

Andaj, bazuar në këto rrethana, e në mbështetje të 18 paragrafi 1 nën paragrafin 1.7 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe nenin 129 paragrafi 1 nën paragrafi 1.2 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Kolegji për shqyrtimin e ankesave, vendosi që ankesa e parashtruar nga ankuesja ██████████ të hedhet poshtë si e pa lejuar.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë -Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës
Lënda A.nr. 263/2020

Çlirim Zeka

Procesmbajtës

Ardita Haxhnikaj -Demi

Kryetare e Kolegjit



Vendimi i dërgohet

- Ankueses [REDACTED],
- Drejtorit të Përgjithshme të Autoritetit të Aviacionit Civil;
- Udhëheqësit të Personelit në Autoritetin e Aviacionit Civil;
- Arkivit të KPMShCK-së

